



A.nr.367/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi- Kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.367/2026 të datës 27.03.2026, të parashtruar nga ankuesi B.B nga Fushë Kosova, kundër organit të punësimit/Komuna e Fushë Kosovës, në çështjen juridike, “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në mbështetje të nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1. të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 18.08.2026, nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.367/2026, e datës 27.03.2026, e parashtruar nga ankuesi B.B. **Anulohet** Njoftimi i datës 18.02.2026 i Udhëheqëses së Personelit në Komunën e Fushë Kosovës, ndërsa çështja *kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje* të organi i njëjtë.

II. Obligohet Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të rishqyrtoj çështjen e ankuesit si objekt i kësaj ankesë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi B.B (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*) më datë 27.03.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes së udhëheqësit të personelit në Komunën e Fushë Kosovës të datës 18.02.2026, lidhur me transferimin e përhershëm nga pozita aktuale e punës *Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1 në Zyrtar i Shërbimeve Sociale*.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit të Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Fushë Kosovës, ndërsa, kjo e fundit, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me dokumentet e bashkangjitura të lëndës në çështjen përkatëse ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1963/2026 e datës 27.03.2026 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; ID identifikuese e ankuesit; Kërkesa e datës 17.01.2025 e ankuesit; Kërkesa e drejtorit drejtuar Kryetarit të Komunës së Fushe Kosovës e datës 29.01.2026; Kronologjitë e emailava lidhur me transferimin e përhershëm të datës 05.02.2026, 18.02.2026; Akt emërimi i ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e bazuar, **sepse:**

I. Gjendja e çështjes

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se:

- Ankuesi sipas Akt emërimit me Nr.1140/2024, të datës 19.12.2022, është i punësuar në pozitën e punës *Zyrtar për Mirëqenie Sociale*, në Sektorin për Asistencë Sociale, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale- Qendra për Punë Sociale.
- Ankuesi fillimisht më datë 17.01.2026, peronës shkresës me numër 60 dhe emailit zyrtar i është drejtuar më kërkesë Kryetarit të Komunës dhe Personelit të Komunës për transferim të përhershëm në vendin e punës nga pozita e punës aktuale *Zyrtar i Mirëqenies Sociale 1 në pozitën e punës Zyrtar i Shërbimeve Sociale*.
- Drejtori i QPS në Komunën e Fushë Kosovës, me kërkesë me numër 126 të datës 29.01.2026 i është drejtuar Kryetarit të Komunës, nënkryetarit dhe udhëheqëses së personelit, për të mundësuar lëvizjen e zyrtareve brenda QPS-se së Komunës së Fushë Kosovës për transferim të përhershëm/ndërrim te pozitave të punës sipas pajtimit të zyrtareve.
- Tutje më datë 05.02.2026, ankuesi ka përsëritur kërkesën për transferoi të Kryetari i Komunës, nënkryetari dhe udhëheqësja e personelit.
- Më datë 18.02.2026, Udhëheqësja e Zyrës së Personelit të Komunës së Fushë Kosovës lidhur me kërkesën e ankuesit njoftuar ankuesin: *...duke ju referuar kërkesës tuaj lidhur me transferimin në një pozitë të punës, bazuar në nenin 11 paragrafi 3 Transferimi i përhershëm mund të behët në një njësi tjetër administrative në kuadër të institucionit të njëjtë ose në institucion tjetër që punëson nëpunës civil” të Rregullores (QRK) nr. 02/2024 për Transferimin e nëpunësve civil. Duke u bazuar në këtë rregullore kërkesa e juaj është refuzuar.*

II. Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 18.02.2026, të udhëheqëses së personelit të Komunës së Fushë Kosovës, pretendon se përgjigjja është në kundërshtim me rregulloren e transferimin e nëpunësit civil. Kërkon që të aprovohet ankesa dhe te obligohet Komuna e Fushë Kosovës që të aprovoj lëvizjen e dy zyrtareve në pozita nga Sektori i Asistencës Sociale në Sektorin e Shërbimeve Sociale.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit fillimisht thekson faktin se një pozitë e caktuar në shërbim civil mund të plotësohet përmes procedurës së rekrutimit dhe transferimin më kushtin që të respektohen kërkesat ligjor të përcaktuar më Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, andaj, duke qenë se objekti i ankese i referohet mos aprovimit të kërkesës për transferim të përhershëm të ankuesit, Kolegji iu referua nenit 65 të këtij ligji, më të cilin përcaktohet se: 1. *Nëpunësja/i civil mund të transferohet për interes të institucionit në mënyrë të përhershme në vend tjetër të punës për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori të shërbimit civil. Për rastet kur nëpunësja/i civil është e nivelit drejtues të ulët, mesëm apo të lartë, transferimi sipas këtij neni bëhet për periudhën e mbetur të mandatit për të cilin është emëruar*, 2. *Transferimi i përhershëm mund të bëhet në një njësi tjetër administrative në kuadër të institucionit të njëjtë ose në institucion tjetër të shërbimit civil.* 3. *Përgatitja profesionale e nëpunëses/it që transferohet duhet të jetë në përputhje me kërkesat e pozitës në të cilën transferohet.* 4. **Transferimi i nëpunëses/it civil brenda institucionit të njëjtë bëhet në pajtim me udhëheqësen/in e drejtpërdrejtë, udhëheqësen/in më të lartë administrativ dhe me pëlqimin e nëpunëses/it civil.** 5. *Transferimi i nëpunëses/it civil në një institucion tjetër të shërbimit civil, bëhet në pajtim me pëlqimin e nëpunëses/it dhe me marrëveshje në mes të institucioneve..* Andaj, në kuptim të këtij përcaktimi ligjor dhe duke qenë se rastin konkret janë plotësuar dy kushtet për transferim gjegjësisht udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit ka parashtruar kërkesë për transferim dhe ankuesi është pajtuar me këtë transferim, atëherë, në vlerësimin e Kolegjit Kryetari i Komunës duhet ta rivlerësoj edhe çështjen e transferimit në fjalë, kurse, Njësia e Personelit është përgjegjëse të vlerësoj vetëm nëse ankuesi plotëson kriteret e pozitës në të cilën kërkohet transferimi.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 10 dhe 97 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje referuar: LPPA), ku parashihet se: **neni 10, paragrafi 2** *Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative,* **neni 97 paragraf 1.** *Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative, dhe si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes,* konstatoi se vullneti i organit publik në realizimin e autoritetit publik formësohet në procedurë administrative dhe manifestohet në formën e njërit prej veprimeve administrative, siç janë: akti administrativ; kontrata administrative apo akti real, dhe se në vlerësimin e Kolegjit, atëherë organi përkatës i punësimit, respektivisht Personeli i Komunës së Fushë Kosovës duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është i obliguar që në raport me kërkesën e ankuesit të datës 30.01.2026, të nxjerr akt administrativ duke vepruar në pajtim me ligjin material dhe pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi.

Thënë si me sipër e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda : A.nr.367/2026

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit B.B;
- Komunës së Fushë Kosovës: Kryetarit të Komunës dhe Udhëheqësit të Personelit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.